**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e pranimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Fatmir Krasniqi** | **26.04.2024** | **30.04.2024** | **2024/0349** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me daten: 22.04.2024, G.O.E Dauti Komerc SH.P.K & Dauti Komerc AD Saraj Shkup ka parashtruar ankese me nr: 2024/0349, kunder njoftimit mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me artikuj ushqimor, për lot 3 me nr. te prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokruimit. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlerë e madhe, vlera totale e parashikuar e kontratës: 660,000.00€ Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotesuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti

Neni 7 - Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi

Nenit 54 - Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Neni 59 - Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Neni 60 - Kriteret e dhënies

Parimet e Prokurimit Publik

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Neni 40 -Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 97- Shkeljet e Renda.

Udhëzuesi për Prokurim Publik nr. 001/2023

0 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

KRITERET PËR VLERËSIM

**Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i komisionit të rivlerësimit është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe me datë 29.03.2024 është ngritë në platformën elektronike E-prokurimi. Në raport është përshkuar se komisioni është mbështetur dhe ka zbatuar vendimin e OSHP-se me nr 964/23 të datës 15.03.202, duke e eliminuar ofertën e Dauti Komerc AD Saraj Shkup, Gërlicë, 70000, Ferizaj, Kosovë për Lot 3 dhe duke rekomanduar për kontratë N.T.P "HAJDINI COMERC ".

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

**PSH 964/23 i datës 15.03.2024**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Dauti Komerc SH.P.K.**

**Sqarim Hyrës**

OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht përmes vendimit nr.964/23 të lëshuar me datë 15.03.2024 ishin trajtuar dhe janë konsideruar si të bazuara, dhe sipas vendimit të OSHP-se nga AK ishte kërkuar që për aktivitetin e prokurimit të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës duke e kthyer lënden në ri-vlerësim.

Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë sikur në ekspertizën me nr. 964/23 dhe në vendim e Panelit Shqyrtues me nr. 964/23 të lëshuar me datë 15.03.2024. Përkundër qe vendimi ka rezultuar me rivlerësim nënkupton se pretendimet ankimore kane qenë të bazuara dhe AK ka pas për obligim që te evitoj shkeljet e konstatuara ne raport të ekspertizës dhe ne vendimin e PSH-së dhe ti korrigjoj ato përmes rivlerësimit, por AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin e ri-vlerësimit.

Vlenë të ceket fakti se komisioni i rivlerësimit në rastin konkret arsyen e eliminimit për LOT 3 të OE ankues e bazon vetëm në vendimin e OSHP-se me nr.964/23 të datës 15.03.2024 dhe quditërisht të njejtin Grup të OE-ve e rekomandon për kontratë në lotin 5. Nëse komisioni i vlerësimit-respektivisht ZPP eliminimin e OE ankues për lot 3 e ka mbështetur në vendimin e OSHP-së siç e potencon në raportin e vlerësimit dhe në Njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 03.04.2024 atëherë, është dashur që Operatorin Ekonomik Ankues ta eliminoj edhe nga LOT 5 konform vendimit PSH 964/23 të datës 15.03.2024 dhe nenit 26.12 të rregullores për prokurimim publik nr. 001/22 për faktin se i njëjti ka deklaruar se nuk është duke marr pjesë individualisht dhe në grup për këtë aktivitet të prokurimit. Neni 26.12 *"Nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet të prokurimit të ndarë në LOT-e, në njërin LOT konkurron si i vetëm, ndërsa në një Lot tjetër në grup, kjo kompani nuk mund të dorëzoj deklaratën që konfirmon se ai anëtar nuk është duke marre pjese në mënyre individuale dhe/aponë ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit dhe* ***rrjedhimisht të dy ofertat refuzohen*****".** Provë deklarata mbi themelimin e grupit.

**Aneksi 6** **DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT**

Te nenshkruhet nga secili anetari / grupdjepi konsorciumi qe aplikon

**Per: Agjencia Qendrore e Prokurimit**
(me vendosjen "autoriteti kontraktues")

**Titulli i aktivitetit te prokurimit: Furnizim me artikuj ushqimor**

**Numri i Prokurimit**:UA/2016-23-9179-1-1-1

KJO LETER E GELLIMIT paraqesi dhe deklarojme se:

Palët e nenshkruara me poshtë:

1. Shtesë emrin e plotë te kompanisë Dauti Komerc SHPK Ferizaj me zyrë te regjistruar ne p.n Gerbat Ferizaj
2. Shtesë emrin e plotë te kompanisë Dauti Komerc SH.A Shkup me zyrë te regjistruar ne n 1723 ne 20 Sarq Shkup R.Maqedonia se Veriut

ptto apas renditjes .....

Hyjne ne bashkëpunim / konsorcium , për qëllim te këtij tenderi me titull "**Furnizim me artikuj ushqimor**" me numer te prokurimit UA/2016-23-9179-1-1-1, Palët konfirmojne se:

- palët deklarojne qartë se si anëtarët te grupit jane bashkëkohë dhe individualisht përgegjegjës për pjesëmarjen e grupit te tenderit dhe, ne rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës
- palët konfirmojnë se marrëdjenia me palët grup dhe se asa nuk janë duke marrë pjesë në asnjë grup tjetër se marrëdjenia me procedurën e njëjtë te prokurimit,
- palët me këtë deklarate autorizojnë partnerin kryesor për të veprua në emër te grupit, i cili është

Emri i Operatorit Ekonomik ( titar ) : Dauti Komerc SHPK Ferizaj

Emri Mbiemri i Perfaqesuesit i autorizuar | Bashkim Krasniqi

Data/Nenshkrimi / Vula 24.10.2023

Perfaqesuesi i autorizuar do te nenshkruaj formularin e tenderit dhe do te jepë dhe ndonjë dokument tjetër qe nuk kërkohet ne kundërshtim me kërkesat e lësuq dëqe te tenderit ose LPP-se.

Anetarët e tjerë te grupit

Emri i Operatorit Ekonomik Dauti Komerc SH.A Shkup

Emri Mbiemri Xhemail Dauti

Data/ Nenshkrimi/ Vula 24.10.2023

Eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së vendosja e kritereve të përzgjedhjes, vlerësimi i ofertave, ashtu që arsyet e eliminimit duhet të bëhen në harmoni të plotë me nenin 56 pargrafi 3 i LPP-së në mënyrë që lejojnë trajtim të barabartë në mes operatorëve ekonomik, të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores se Punës se OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore 1,2 dhe 4 janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e Panelit Shqyrtues. Andaj, konsideroj se çështja për pretendimet 1,2 dhe 4 të trajtohen si **" Res- Judicata".**

**Lidhur me pretendimin e tretë të OE ankues,** Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve dhe dëshmive në platëformen elektronike e-prokurimi AK në dosje të tenderit tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale ka aplikuar kritrerin e përzgjedhjes si në vijim:

**Kërkesa 2:** Operatori ekonomik duhet të jetë i akredituar nga institucioni i pavarur sipas ISO standardeve, **ISO 22000:2018** - *Food safety management systems, ose ekuivalente apo më të avancuara. Për Lot 1 dhe 2 - për mish; për Lot 3 – për qumësht; për Lot 4 dhe 5 – për produkte ushqimore; per Lot 6 dhe Lot 7 – për produkte të grurit ose per industrin e furrës së bukës.*

**Evidenca 2:** Certifikata që është në pajtueshmëri me standardet ISO 22000:2018; ose certifikatë *ekuivalente apo më të avancuara*

Më tej, Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në procesverbalin e hapjes së ofertave, ofertat janë hapur me dt 25.10.2023 dhe OE N.T.P"HAJDINI COMERC ", së bashku me ofertë ka dorëzuar edhe ISO 22000:2018, me validitet deri me dt. 15.01.2025 kurse anëtari i grupit të OE Drena ka dorëzuar ISO 22000:2018, me validitet deri me dt. 11.04.2024. Siç vërehet në kohën e hapjes së ofertave, certifikatat ISO kanë pasur validitet, përveç kësaj të njëjtat konsideroj se janë në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se AK në kërkesën e saj tek evidenca dy(2) nuk ka kërkuar që certifikata të ketë validitet të caktuar. Kurse sa i përketë pretendimit tjetër se Qarkullimi total i deklaruar nga "N.P.T HAJDINI COMERC" me CD ka vlerën e 8.2 milion euro në tri vitet e fundit ndërsa tek referencat per tri vitet e fundit ka deklaruar mbi 8.7 milion euro. Kjo përveç që sjelle dyshime të mëdha se si është e mundur një gjë e tillë gjithashtu sjellë ndërmend dhe duhet të ceket që kjo kompani të gjithë qarkullimin e saj e ka përmes kontratave me sektorin publik dhe për më tepër vetëm me 3 institucion që janë AQP, Shërbimi korrektues dhe Policia e Kosovës. Apo rreth 2.8 milion euro ka siguruar qarkullim vetëm nga kontratat e AQP-së e që në raport me qarkullimin total të tij është mbi 35%, një gjë e tillë në një shtet të zhvilluar nuk do të konsiderohej si normale pasi që pikërisht

kjo është konkurrencë jo e drejtë dhe me tendenca të shkuarjes në drejtim të oligarkisë ku vetëm një grup i caktuar i OE-ve përfitojnë nga kontratat shtetërore dhe nuk ju jepet mundësia OE-ve të tjerë si në rastin konkret ku ne eliminohemi pa asnjë bazë ligjore.

Eksperti shqyrtues sqaron se, grupi i OE N.T.P "HAJDINI COMERC& Drena shpk " për ta përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit, nga kapaciteti ekonomik financiar ka ngarkuar deklaratat vjetore të ATK-së vetëm për tri vitet dhe atë 2020,2021 dhe 2022, kurse për të dëshmuar qarkullimin specifik për referenca OE ka ngarkuar edhe fatura të vitit 2023 dhe kontrata të vitit 2019 rrjedhimisht edhe vlera ndryshon. Me qëllim të qartësimit sa më të mirë të pretendimit ankimor, në ekspertizë do ti paraqes vetëm vlerat e lotëve në të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë ato janë si më poshtë:

**Kërkesa 1:** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizim me produkte të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) minimum:

**Lot 3: 800,000.00€**

**Lot 4: 1,600,000.00€**

**Lot 5: 1,300,000.00€**

Grupi i OE N.T.P "HAJDINI COMERC& Drena shpk " për ta përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit nga kapacitetit teknik profesional, kishte dorëzuar, dy lista të kontratave të relaizuara gjatë tri viteve të fundit, lista e parë është në vlerë prej 8,721,169.78€ dhe listën e kontratave të realizuara nga anëtari Drena në vlerë prej 5,967,220.82€. Vlenë të ceket fakti se kontratat e realizuara janë në institucione të ndryshme nga sektori publik dhe privat si: AQP-ja, MPB-ja, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Komuna e Prishtinës, Policia e Kosovës, Elkos Group, Viva FLY shpk, Meridian Express shpk, The north Unicron dhe Proex shpk. Duke ju referuar të lartëcekurave, konsideroj, se OE N.T.P "HAJDINI COMERC " e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit për lotët në të cilat ka aplikuar. **Andaj në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë nuk qëndron.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Dauti Komerc SH.P.K.**

**Fatmir Krasniqi**